

# Gra dhe vajza : Mos heshtni ! Raportoni dhunën e ushtruar ndaj jush! Dhuna rrezikon shëndetin!

Në raste të ushtrimit të dhunës ndaj jush kërkon shërbime  
në qendrën shëndetësore më të afërt!



QENDRA "PO"

Bulevardi: "Gjergj Fishta",  
Kompleksi "Tirana 2000", Kulla 8, Kati 2, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 042 253 839  
Email: Qendra.PO@gmail.com  
www.facebook.com/qendrarinorePO



QENDRA "AULONA"

Lagjia 29 Nëntori, Çerdhja 15, Kati 2  
Tel: 033 224531  
Email: aulona.center@gmail.com  
www.facebook.com/qendra.aulona

## Unë zgjedh TË JETOJ PA DHUNË



25 Nëntor 2015

Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave



## Eliminimi i dhunës ndaj grave përfshin fuqizimin e tyre për të avokuar për të drejtat e tyre, për të marrë vendime për jetën e tyre, si dhe për të marrë pjesë në jetën e komuniteteve të tyre.

Edhe pse kushdo mund të jetë viktimë e dhunës, përfshirë fëmijët, gratë dhe burrat e çdo moshe, të dhënat e kohëve të fundit tregojnë se një në tri gra në botë ka përjetuar gjatë jetës dhunë fizike dhe/ ose seksuale nga partneri intim apo person tjetër.

Tabelë krahasuese:

### Gratë viktimat të dhunës psikologjike

Shqipëria	Bashkimi Europian
1 në 2 gra	2 në 5 gra

### Gratë viktimat të dhunës fizike dhe seksuale

1 në 4 gra	1 në 5 gra
8 % e grave të dhunuara kërkojnë ndihmë për ndalimin e dhunës në jetën e tyre.	33% e grave të dhunuara në BE kërkojnë ndihmë pranë shërbimeve sociale dhe organizatave (nga BE, studim 2014)

Shënim: Referuar buletinit të përgatitur nga Dr Robin Haart (Botim i Zyrës së Kombeve të Bashkuara në Shqipëri)

Në Shqipëri 59,4% e grave dhe vajzave (18-55 vjeç) kanë përjetuar dhunë në familje gjatë jetës së tyre. (INSTAT 2013)

Gratë, që përjetojnë dhunë nga partneri, kanë dy herë më shumë të ngjarë të vuajnë nga depresioni dhe 1.5 herë më shumë të kenë infeksione seksualisht të transmetueshme përfshirë HIV, krahasuar me ato që nuk janë ekspozuar ndaj kësaj dhune.

Kur dhuna ndodh gjatë shtatzënisë, ato mund të kenë shtatzëni të padëshiruara, aborte të pasigurta dhe, ato mund të kenë aborte spontane, lindje të parakohshme dhe lindje të foshnjave nënveshë.



## Axhenda 2030

Eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha praktikave është në qendër të Axhendës 2030 “Për Zhvillim të Qëndrueshëm” dhe përfshin objektiva specifike. Objektivi 5 “Për Zhvillimin e Qëndrueshëm”, i njohur dhe si “Objektivi i Barazisë Gjinore”, me treguesit e tij adreson barrierat strukturore të të drejtave të grave dhe garanton integritetin fizik dhe sigurinë e tyre, të drejtën e grave për t'u shprehur dhe për të bërë zgjedhjen e tyre.

Axhenda 2030, gjithashtu, promovon të drejtat ekonomike të grave dhe të vajzave duke kërkuar punë të denjë, pagë të barabartë dhe të drejta të barabarta mbi pronësinë dhe kontrollin mbi burimet ekonomike si: toka, prona, teknologjia dhe shërbimet financiare.

Objektivi 5 i “Zhvillimit të Qëndrueshëm” dhe 11 objektivat e tjerë të OZHQ përbëjnë një strukturë, që përfshin “Platformën e Veprimit të Pekinit” dhe Konventën “Për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave ( CEDAW)” si korniza themelore për zhvillim të qëndrueshëm, duke ofruar mundësi reale për të drejtat dhe barazinë e grave.

